



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	146 / 16
Nr. i fq. / Br. st	- 3 -
Data / Datum	28. 07. 2016
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA Mbledhja jashtëzakonshme e VII-A me radhë e Kuvendit të
Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më 20 Korrik 2016

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 16:10.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri:

Adnan Klinaku, Agim Bregaj, Ali Januzi, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Fakete Dushi, Fatime Haziri, Habibe Gërzhaliu Habib Mustafa, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Syzana Sylja, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakiç.

Munguan: Hysni Gërguri, Agron Perçuku dhe Arta Ismajli.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Sami Istrefi, drejtor i DUMM-së paraqiti sqarime hyrëse para anëtarëve të kuvendit duke shtuar që me hartimin dhe më vonë aprovimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe hartimin e dhe aprovimin e hartës zonale po konsolidohet infrastruktura ligjore në lëmin urban në Komunën e Vushtrrisë. Tutje shtoi se rekomandimet të cilat i ka dhënë komisioni i MMPH ka të bëjë ndër të tjera edhe me ndryshimin e emërimit të këtij dokumenti duke u hequr fjala “revidim”, andaj nga te cekurat më lartë kërkoi nga kuvendi që të aprovohet ky ndryshim për faktin që të hapet rruga që brenda seancës së rregullt të muajit korrik të ofrohet dokumenti final me pëlqim nga ana e MMPH-së me qëllim që të hapet rruga për zbatimin të Planit të Ri Zhvillimor Komunal në gjithë territorin e Komunës së Vushtrrisë në bazë të ligjeve të cilat e rregullojnë fushën e planifikimit hapësinorë. Në fund kërkoi nga kuvendi që të aprovohet ky ndryshim me qëllim që të bëhet i mundur marrja e pëlqimit nga ministria gjegjëse dhe kështu të shkohet në aprovimin final të këtij plani.

Kuvendi pas votimit me vota me 25 vota “për”, të tjerat “abstenim” aprovoi këtë:

RENDITE

1. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për ndryshimin e vendimit Nr.98/14 të datës 24.04.2016 (lidhur me Planin Zhvillimor Komunal).

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-duke ju referuar shkresës së MMPH-së me numër të protokollit 2935/16 të datës 29.06.2016 ministria në pikën 3.2 komentet specifike në renditjen e tetë ndër të tjera ka rekomanduar që teksti prej faqes 134 deri 135 të plotësohet ose të hiqet krejt me që nuk ndonjë domethënie esenciale andaj në këtë rast ai propozoi që këto dy faqe të hiqen ka dokumenti. Pastaj tek renditja me numër 9 kërkesë e ministrisë është që të hiqet teksti nga faqja 143 deri tek faqja 157 (gjithsejtë 15 faqe), sepse këto kushte sipas ministrisë janë të detajuara dhe të njëjtat duhet të jenë pjesë përbërëse e hartës zonale komunale e që nënkupton që Plani Zhvillimor Komunal që sot po e votojmë nga 235 faqe të rekomanduara në KPF dhe në kuvend do ti ketë 218 faqe të pandryshuara me përjashtim që do të kërkohet nga ministria që të bëhet një rirenditje e re *duke u hequr emërtimi "revidim"*.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit-tha se grupi kuvendar i LDK-së e mbështet propozimin për ndryshimin e vendimit me Nr.98/14 të datës 24.04.2016 lidhur me Planin Zhvillimor Komunal, mirëpo vlerësoi se është një praktik e keqe që ky dokument nuk ka ardhur si tekst i spastruar me qëllim që të shihet se çfarë po ndryshohet me këtë vendim. Andaj lidhur me këtë kërkoi që deri në mbledhjen e ardhshme të ofrohet ky dokument i spastruar në tërësi me të gjitha ndryshimet të cilat do të bëhen. Në fund e përkrahi propozim-vendimin në fjalë për ta aprovuar.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –në rekapitullimin e debatit dhe tezave për Planin Zhvillimor Komunal, ceku se ministria gjegjëse ka kërkuar që të hiqet termi revidim, pastaj tek rekomandimi i VII është thënë "citojmë: teksti nga faqja 73 deri në faqen 77 nuk e ka vendin në këtë pjesë të PZHK-së. Ai duhet të vendoset më prapa në dokument, pra tek kapitulli "Prioritetet strategjike zhvillimore dhe plani i veprimt" në këtë rast duhet të bëhet ky ndryshimi brenda planit. Tutej tek paragrafi VIII i rekomandimeve faqet 134, 135- këtu janë dhënë vetëm titujt :""efektiviteti dhe afati kohor", strategjia për zbatim ...,vlerësimi i strategjive..., afatet kohore ..., dhe analiza e përfitimeve nga shpenzimi (kost-benefiti)...., kurse teksti dhe informatat mungojnë, gjë që nuk ka kuptim. Për këtë arsye këta tituj duhet të plotësohen me tekst ose të hiqen krejtësisht. Mandej tek paragrafi IX sipas Udhëzimit Administrativ mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal, teksti nga faqja 143 deri në faqen 157 nuk e ka më vendin në PZHK. Teksti në këto faqe ka të bëjë me kushte të ndryshme të cilat duhet të plotësohen gjatë zbatimit të PZHK, kushte këto që kërkoheshin me udhëzimin e vjetër administrativ për PZHK. Tani me legjisllacionin e ri, këto kushte, shumë më të detajuara duhet të jenë pjesë përbërëse e hartës zonale komunale e jo e PZHK-së, mbaron citati". Në fund tha se të gjitha këto ndryshime kuvendi i bënë mbi bazën e dokumentit që e kemi pasur dhe që është aprovuar në saje të vendimit Nr.98/14 të datës 24.04.2016 si në bazë të planit i cili është dërguar në diskutim publik.

Sami Istrefi, drejtor i DUMM-së-tha se sa i përket pikave të paragrafëve VII, VIII,IX konsideron se kuvendi nuk ka nevojë të merret me këto rekomandime, pasi që është obligim i Drejtorisë së Urbanizmit që të zbatojë rekomandimet e ministrisë dhe të spastron tekstin me qëllim që të dërgohet materiali i spastruar në ministrinë gjegjëse dhe i njëjti iu dërgohet anëtarëve të kuvendit që do të mund ta analizojnë para se i njëjti të aprovohet përfundimisht. Pastaj ai lidhur me rekomandimin e IX vlerësoi se kjo është bërë me qëllim që të mundësohet ndërtimi nëpër fshatra dhe që zonat rurale të mos mbesin jashtë normave të dalin nga ky planë lidhur me ndërtimet. Në fund tha se votimi i sotshëm nga ane e kuvendit ka të bëjë ekskluzivisht me ndryshimin e termit revidim kurse gjërat tjera që ka kërkuar ministria jemi të obliguar ti zbatojmë si Drejtori e Urbanizmit.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –tha se jemi të obliguar që ti zbatojmë rekomandimet e ministrisë dhe përsërit qëndrimin e tij se këto ndryshime po bëhen në saje të dokumentit që është dërguar në diskutim publik si dhe në bazë të vendimit me Nr.98/14 të datës 24.04.2016 për aprovimin e këtij plani. Kurse sa i përket kushteve ndërtimore nëpër fshatra ceku se nëse ato nuk do të mund të futen në kuadër të këtij plani atëherë do të propozojmë kuvendit që të

nxjerr një rregullore për përcaktimin e kushteve ndërtimore nëpër fshatra. Në përmbyllje të debati lidhur me këtë planë ai e hedhi në votim Propozim-Vendimit për ndryshimin e vendimit Nr.98/14 të datës 24.04.2016 (lidhur me Planin Zhvillimor Komunal), me ndryshmet të cilat i ka kërkuar Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë.

Në fund të diskutimeve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:


1.Me këtë vendim ndryshohet Vendimi me titullin Vendim për Revidimin e Planit Zhvillimor Komunal, i hiqet termi revidim dhe mbetet Vendim për Planin Zhvillimor Komunal..


2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

3. Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.


Mbledhja përfundoi në orën 16:26.

Bastri Duraku


Procesmbajtës



Shpëtim Zhegrova


Kryesues i Kuvendit